# DETAJET/ Çfarë e ‘fundosi’ bandën që realizonin vjedhje, mes tyre edhe gardisti e bankieri. Një biznesmeni në Tiranë i kishin…

*Jun 16, 2020 | 13:04*

SHPËRNDAJE Facebook Twitter Like 3 Tweet

**Tentuan të vidhnin me dhunë dhe nën kërcënimin e armës banesën e një biznesmeni në Tiranë, Policia zbardh ngjarjen dhe arreston 7 nga 8 anëtarët e grupit, pjesë e të cilit ishin edhe një gardist e një punonjës banke.**

Arrestohen 6 persona, njëri prej tyre lidhje me shpër…

Policia tha dje se kishte finalizuar operacionin e koduar “Mozaiku”, i cili u organizua dhe u zhvillua nga shërbimet e Komisariatit Nr.2. Katër ditë më parë, gjatë operacionit policor të koduar “Eksplozivi”, u arrestua dhe një pjesëtar i këtij grupi, Franc Alimi, i cili u filmua duke vendosur tritol në një lokal në rrugën “Sami Frashëri”, shpërthimi i të cilit shkaktoi shumë dëme materiale.

Pas goditjes së këtij grupi, Policia tha se kishte sekuestruar në cilësinë e provës materiale armën e zjarrit dhe veshjet e përdorura gjatë tentativës për vjedhje, dy automjete, një sasi municioni luftarak dhe 5 telefona celularë.

**OPERACIONI** Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 2 Tiranë, pas njoftimit të marrë se në rrugën “Frederik Shiroka”, persona të paidentifikuar kanë tentuar të vjedhin me armë në banesën e shtetasit E. M, por nuk kanë mundur, pasi janë diktuar nga të zotët e banesës, menjëherë kanë organizuar punën për zbardhjen e ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorëve.

Në vijim të veprimeve hetimore të kryera nga ana e strukturave për Hetimin e Krimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u finalizua operacioni “Mozaiku”, si rezultat i të cilit u bë ekzekutimi i urdhrave të ndalimit, për shtetasit: **Spartak Qoku, 30 vjeç, i dënuar më parë për vjedhje në bashkëpunim; Petro Sava, 23 vjeç; Andi Kraja, 28 vjeç, punonjës i një banke të nivelit të dytë; Emel Hajdaraj, 25 vjeç; Klaudio Metaj, 33 vjeç; dhe Aleks Kala, 31 vjeç, punonjës i Gardës së Republikës, i cili u pezullua menjëherë nga detyra.**

Gjithashtu, u shpall në kërkim policor dhe po punohet për kapjen e shtetasit A. Sh., 29 vjeç, banues në Tiranë.

**Nga veprimet hetimore të kryera ka rezultuar se shtetasi Franc Alimi,** 28 vjeç, banues në Tiranë, i cili është arrestuar gjatë operacionit policor të koduar “Eksplozivi”, si autor i dyshuar për veprën penale “Shkatërrim i pronës me eksploziv”, ngjarje e ndodhur më datë 11.06.2020 në rrugën “Dëshmorët e 4 Shkurtit” Tiranë, është bashkautor edhe në këtë ngjarje. Burime zyrtare të Policisë thanë se dyshohet se **shtetasit Spartak Qoku dhe Emel Hajdaraj,** në bashkëpunim me shtetasin E. K. (i arrestuar më parë), janë autorë të vjedhjes së banesës së shtetasit M. Sh., ngjarje e ndodhur në muajin prill 2020.

**Subscribe**

YouTube 7K

262K Like

Për t’u bërë pjesë e grupit të "**Panorama**" mjafton të klikoni: **Join Group** dhe kërkesa do t’ju aprovohet.
**KOMUNITETI PANORAMA ONLINE:**
https://facebook.com/groups/panoramaonline/

Shfaq komente

## Te lidhura



A mund të mbrojnë hormonet femërore nga Covid-19?

Dëshironi një person në krah që t’iu bëjë të ndiheni të veçantë? Ja cilat janë shenjat më romantike të zodiakut

“Kush e di sa do acaroheshe me mua …”- Vajza e Xhevdet Ferrit prek me fjalët për të atin: Nuk më mësove të jetoj pa prezencën tënde

“Nuk jam i pari, më tha që ishte e virgjër”- Burri zbulon pas 15 vitesh martesë që gruaja e kishte gënjyer: Kishte bërë seks edhe me 3 meshkuj të…

“A mund ti lash para se të dalësh në ekran”- Këngëtarja e njohur ngre këmbët përpjetë në emision, shpërthejnë kritikat ndaj saj

## Opinion



Pesëmbëdhjetë pikëpyetje për tridhjetë pyetjet e Letërsisë
*Jun 16, 2020*
**DHURATA SHEHRI**

Puç i Edi Ramës me Kushtetutën?
*Jun 16, 2020*
**GENC BURIMI**

Një atlas me njëqind libra në shpinë
*Jun 16, 2020*
**ZIJA ÇELA**

Përgjimi, jeta private dhe liria gazetareske
*Jun 16, 2020*
**XHEZAIR ZAGANJORI**

Rrotacioni politik si shpëtim kombëtar
*Jun 15, 2020*
**ALEKSANDËR BIBERAJ**

JU REKOMANDOJMË

boost

Gra! Hiqni dorë nga botoksi. Ja zgjidhja për eleminimin e rrudhave Më Shumë
mjekesia.org



“Pse po infektohen mjekët”, flet specialistja e ISHP: Ja çfarë po ndodh. Tirana, qyteti më i
panorama.com.al

Praktike dhe me super efekte, serumi kundër rrudhave, poreve,
mjekesia.org



Pasuritë që fshehu/ Pallati 10 katesh strumbullari i relacionit
panorama.com.al



“Si e rrëmbyem unë dhe vëllai im, vajzën 12-vjeçare të shefit të
panorama.com.al

KURSE DERI NE 50% Më Shumë
Aza Electronics



Covid-19 ‘hyn’ edhe në Kryeministri, detaje nga rastet e konfirmuara pozitive
panorama.com.al

Kroçiera në ishullin privat Ocean Cay Bahamas dhe Karaibe
Kroçiere.al



Rekord të prekurish në 24 orë, sot 82 raste të reja. Si po përhapet
panorama.com.al



“Përgatituni për mundësinë e rikthimit”, OBSH me paralajmërim
panorama.com.al



Rritja rekord e shifrave të të infektuarve, zv ministrja Rakacolli shpjegon çfarë
panorama.com.al

Paguaj faturen e ujit direkt nga celulari me aplikacionin EasyPay Shkarko
EasyPay



Njihej si “gjenerali” i bandës famëkeqe, ndërron jetë në
panorama.com.al

Gati për aventura të reja këtë verë?
Megatek



Kujtimet e Arben Malajt për Fatos Nanon dhe “qeverinë hije të PS”:
panorama.com.al

## Na Kontaktoni

Per reklama, spote publicitare dhe bannera kontaktoni me redaksine Tone me ane te postes elektronike: marketing@panorama.com.al

**Adresa:** Rr.”Panorama” (prapa shkolles “Harry Fultz”). Nd.3, H.14, Ap.3, Njesia bashkiake nr.9, Kodi postar 1016, Tirane.

Fax: 00355 42 403 206
Tel: 00355 42 403 207/08/09
E-mail: info@panorama.com.al, gazetapanoarama@hotmail.com, gazetapanorama@yahoo.com
Website: www.panorama.com.al
Subjekti: Panorama Group Sh.A
NIPT: K22112005E



© Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga Gazeta Panorama. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të Panorames. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi dhe publikimi i paautorizuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të Panorama-s. Shfrytëzimi i materialeve pa lejen e Grupit Panorama është shkelje e te drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin. Të gjitha të drejtat Gazeta Panorama